



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. ___, datë __/__/2025

PËR

PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR MARRJEN, TRAJTIMIN E MOSTRAVE DHE KRYERJEN E EKSPERTIZAVE, SI DHE MIRATIMIN E METODOLOGjisë SË LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE NË KËTO PROCEDURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 8, të nenit 51, të ligjit nr. 99 datë 12. 09. 2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive, sipas tipit të inspektimit për qëllime të procedurës së inspektimit, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Miratimin e metodologjisë për llogaritjen e shpenzimeve për marrjen e mostrave dhe për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive, sipas tipit të inspektimit.
3. Ngarkohen Ministritë përgjegjëse, Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore dhe inspektoratet vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
EDI RAMA**

**RREGULLA PËR PROCEDURA TË HOLLËSISHME PËR MARRJEN, TRAJTIMIN E
MOSTRAVE DHE KRYERJEN E EKSPERTIZAVE, SI DHE MIRATIMIN E
METODOLOGjisë SË LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE NË KËTO PROCEDURA**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të përgjithshme për:

- a) Kryerjen e procedurave për marrjen, trajtimin e mostrave dhe kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive, sipas llojit të inspektimit;
- b) Kryerjen e analizave për verifikimin e përputhshmërisë të treguesve të sigurisë dhe cilësisë me përshtatshmërinë e llojeve të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve të analizuara, si dhe ekspertizave të pajisjeve, proceseve apo makinerive, gjatë procedurës inspektuese;
- c) Dhënien e rezultateve të analizave dhe vlerësimit të tyre për subjektin e inspektuar dhe pasqyrimi i tyre në dokumentacionin e inspektimit;
- ç) Metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve për kryerjen e këtyre procedurave.

KREU II
FUSHA E ZBATIMIT

Ky vendim është i zbatueshëm nga inspektoratet qendrore dhe inspektoratet vendore në Republikën e Shqipërisë, të ngarkuara me një ose disa funksione inspektimi, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të ligjit për inspektimin dhe legjislacionit të posaçëm.

KREU II
PËRKUFIZIME

1. “Mostër”, sasia e produktit, materialeve, mallrave, substancave, si dhe pajisja, procesi apo makineria, e marrë si kampion për kryerjen e analizës së parë, analizës së dytë dhe analizës së tretë laboratorike;
2. “Etiketa e mostrës”, modeli i shkruar, që plotësohet nga trupa inspektuese me të dhënat që kërkoohen për identifikimin e mostrës për kryerjen e analizave zyrtare;
3. “Kod identifikimi”, një numër që vendoset nga trupa inspektuese, për të ruajtur identitetin e prodhuesit.

KREU III
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

KREU IV
PROCEDURA PËR MARRJEN E MOSTRAVE PËR ANALIZË

1. Gjatë kryerjes së inspektimit, nëse trupa inspektuese gjykon se është e nevojshme, ose kur parashikohet nga legjislacioni i posaçëm që të vërtetohet teknikisht nëse produktet, materialet, mallrat, substancat, prodhimet, pajisjet, proceset apo makineritë, përputhen me

standardet e cilësisë të vendosura nga legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ai mund të marrë, pa pagesë, mostra për analizimin ose shqyrtimin e tyre.

2. Subjekti i inspektuar është i detyruar të vendosë në dispozicion të trupës inspektuese, mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve në masë/sasi të mjaftueshme, por në çdo rast jo më pak se 5 mostra identike, për kryerjen e analizave, apo për të siguruar përsëritjen e tyre nëse është e nevojshme.
3. Trupa inspektuese, për mostrat e marra, i lëshon subjektit të inspektimit "Vërtetim për marrje mostre", që shërben si dëshmi se janë marrë mostra nga materiali, produkti apo procesi i kontrolluar dhe siguron transparencë dhe gjurmueshmëri për të dyja palët. Vërtetimi për marrje mostre përmban informacion si:
 - a) Data dhe vendi i marrjes së mostrës;
 - b) Emri dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit;
 - c) Emri dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të trupës inspektuese;
 - ç) Përshkrimi i mostrës;
 - d) Qëllimi i marrjes së mostrës (p.sh. analiza laboratorike);
 - dh) Sasia apo numri i mostrave të marra.
4. Vërtetimi i marrjes së mostrës përpilohet në 2 (dy) kopje, ku 1 (një) nga kopjet mbahet nga inspektorati qendror dhe është pjesë përbërëse e dosjes së procedimit përkatës, ndërsa kopja e dytë i dorëzohet subjektit të inspektimit në mjediset e tij, gjatë procesit të inspektimit.
5. Vendimi procedural për marrjen e mostrave, pasqyrohet, gjithashtu, në procesverbalin e inspektimit.
6. Trupa inspektuese dërgon në një kohë sa më të pranueshme pranë institucionit të specializuar një nga mostrat e marra, për kryerjen e analizave, në mënyrë që mostra e marrë mos të humbasë vetitë/ cilësitë që e karakterizojnë dhe që do të jenë objekt i analizimit/testimit.
7. Produkti i mostrave të marra, ruhet në ambalazhin fillestar apo ambalazhohet në mënyrë të tillë që të mos cenohet integriteti dhe siguria e produktit. Kur produktet nuk janë të reja (të marra drejtperdrejtë nga zinxhiri i shitjeve) dhe sidomos kur ato hetohen si pjesë e një çështjeje gjyqësore, do t'i kushtohet vëmendje e posaçme ambalazhimit të produktit, në mënyrë të tillë që vetë produkti të mos ndryshojë.
8. Katër mostrat e marra ndahen në mënyrë rastësore në:
 - i. 1 mostrë kryesore (A), për ekspertizën apo ekzaminimin e parë laboratorik;
 - ii. 2 mostra rezervë (R1), që mbahet për efekt të përsëritjes së akteve të ekspertimit në nivelin e shqyrtimit të ankimimit administrativ;
 - iii. 2 mostra rezervë (R2), që mbahet, përrastet e mosmarrëveshjeve gjyqësore me subjektin, për të cilat gjykata mund të kërkojë kryerjen e një ekspertimi të ri.
9. Secila nga pesë mostrat e marra etiketohet në mënyrë të përshtatshme. Etiketimi përmban një numër unik identifikimi të mostrës dhe kategorisë së mostrës (mostra kryesore (A), mostra rezervë (R1 ose R2).
10. Numri unik i identifikimit është pjesë e një regjistri të mostrave të krijuar nga inspektorati qendror përgjegjës. Në regjistrin përkatës numri unik i identifikimit lidhet me numrin e procedimit administrativ, që është numri i dosjes së procedimit në fjalë.

11. Mostra kryesore (A) dërgohet në laborator, ndërsa dy mostrat e tjera, të shoqëruara me kopjen e dytë të vërtetimit, ruhen në ambiente të përshtatshme për këtë qëllim nga struktura përgjegjëse e inspektoratit.
12. Mostra kryesore dërgohet në një laborator të akredituar apo të autorizuar, sipas kësaj radhe preference:
 - i. laboratorët e inspektoratit qendror përkatës;
 - ii. laboratorë të tjerë shtetërore; apo
 - iii. laboratorë privatë të akredituar për këtë qëllim vendas ose të juaj.
13. Gjatë kryerjes së testeve, laboratori vendos, gjithashtu, numrin e tij unik të identifikimit për mostrën e sjellë për analizim.
14. Laboratori përqendrohet vetëm në testimin e karakteristikave/vetive për të cilat produksi është ose jo në përputhje me standartet. Gjetjet përmblidhen në Raportin e Analizës, që mbahet në tri kopje. Një nga kopjet mbahet në laborator, ndërsa tjetra bëhet pjesë e dosjes së procedimit përkatës në sistemin “e-Inspektimi”.
15. Raporti i Analizës/Testimit përshtuan vetitë/karakteristikat për të cilat produksi është ose jo në përputhje me kërkesat e sigurisë. Raporti i Analizës/Testimit, i përgatitur nga laboratori përkatës, nuk vlerëson rrezikshmërinë e mospërputhjeve të konstatuara.
16. Trupa inspektuese, njofton me shkrim subjektin e inspektuar në të cilin janë marrë mostra për analiza, brenda 24 orëve nga data e marrjes së rezultatit të analizave të mostrës së parë, të ardhura zyrtarisht nga laboratori që i ka kryer ato, shoqëruar me vendimin përkatës;
17. Trupa inspektuese, evidenton në procesverbalin e inspektimit pëershkrimin, llojin, sasinë dhe cilësitë e mostrës/mostrave të marrë/a, si dhe bashkëngjit në të një kopje të fletë analizës si pjesë e dosjes së inspektimit dhe dokumentohet e administrohet nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”.
18. Trupa inspektuese, ruan me kujdes dhe në kushtet e përshtatshme mostrat e tjera, deri në daljen e rezultateve të analizave për mostrën e parë të dërguar.
19. Nëse rezultati i analizave provon që nuk ka pasur shkelje të kërkesave ligjore, trupa inspektuese kthen mostrat e mbeturë të pa analizuara.

KREU V TRAJTIMI I MOSTRAVE PËR ANALIZË

1. Trupa inspektuese, gjatë procedurës së inspektimit merr mostrën për verifikimin e cilësisë së lëndës për analizë për vlerësimin e përputhshmërisë, në përputhje me standartet e cilësisë të vendosura nga legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Trupa inspektuese merr mostrën e produkteve gjatë procesit të inspektimit, në të gjitha rastet kur ka dyshime të arsyeshme ose ka tjetësim apo ndryshim të parametrave të tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që përcaktojnë standardin.
3. Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në legjislacionin e posaçëm, trupa inspektuese gjykon dhe vendos për treguesit e sigurisë së cilësisë, llojin e analizës, si dhe kur e gjykon të arsyeshme vendos për tregues cilësor shpesë që do t'i nënshtrohet analizave/mostra, për të provuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

4. Procedura e marrjes së mostrave, të planifikuara në kuadër të programit vjetor të bazuar në vlerësimin e riskut, realizohet zakonisht në mënyrë të koordinuar dhe të njëkohshme me zbatimin e programit mëjor të inspektimeve, ku trupa inspektuese merr edhe mostrat e parashikuara, pa pasur nevojë për inspektime të veçanta. Marrja e mostrave planifikohet në mënyrë që të mos cënojë efektivitetin e inspektimeve dhe as cilësinë e mostrave, veçanërisht kur kërkohet ruajtje në kushte të veçanta.
5. Përjashtimisht, procedura e inspektimit në subjekt kryhet me objekt inspektimi marrjen e mostrave, në rastet kur ministri përgjegjës ose inspektori i Përgjithshëm urdhëron me një urdhër të posaçëm kryerjen e një inspektimi tematik të caktuar për marrjen e mostrave jashtë planit vjetor të miratuar për marrjen e mostrave me bazë risku.
6. Në rastet kur sipas legjislacionit të posaçëm evidentohet programimi i inspektimeve për marrjen dhe analizimin e mostrave, procedura inspektuese autorizohet nga kryeinspektori qendror nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”.

KREU VI
MARRJA DHE DORËZIMI I MOSTRAVE

1. Marrja e mostrave kryhet sipas procedurave të miratuara të secilit inspektorat për marrjen e mostrave që përfshijnë inspektorin/at e autorizuar për marrjen e mostrave, metodat dhe pajisjet që duhet të përdoren, sasitë që duhet të merren dhe çdo masë që duhet të respektohet për shbangjen e tjetërsimit të materialit ose ndonjë përkëqësim në cilësinë e tij.
2. Marrja e mostrave duhet të bëhet në përputhje me procedurat e miratuara nga inspektoratet përkatëse të cilat përshkruajnë:
 - a) Çdo masë paraprake për t'u patur parasysh lidhur me marrjen e mostrave, përfshirë përgatitjen e pajisjeve dhe parandalimin e ndotjes nga materiale/lëndë të dëmshme;
 - b) Gjendjen e pajisjeve sipas llojit, të cilat do të përdoren për marrjen e mostrës;
 - c) Identifikimin e mostrave të marra;
 - ç) Kushtet e ruajtjes dhe të transportit të mostrës së marrë;
 - d) Metodën e marrjes së mostrave;
 - dh) Pajisjet që do të përdoren për marrjen e mostrës;
 - e) Sasinë e mostrës që duhet të merret;
 - ë) Udhëzimet për çdo nën-ndarje të kërkuar të mostrës;
 - f) Udhëzimet për pastrimin dhe ruajtjen e pajisjeve të përdorura për marrjen e mostrave.
3. Mostrat duhet të përfaqësojnë materialet ose produktet e serisë nga e cila janë marrë.
4. Pajisjet e marrjes së mostrave duhet të kenë një etiketë e cila tregon përbajtjet, me numrin e serisë, datën e marrjes së mostrës dhe kontejnerët (ngarkesat) nga të cilët janë marrë mostrat.
5. Përgatitja e mostrës bëhet si më poshtë:
 - a) Çdo mostër shoqërohet me formular të marrjes së mostrës. Formulari plotësohet në momentin e marrjes së mostrës dhe në prani të subjektit të inspektimit ose përfaqësuesit të tij, në sistemin “*e-Inspektimi*” (Aneksi I);
 - b) Mostrat vendosen në pajisjet (mbajtëset) e marrjes së mostrave. Secila mostër vendoset në një pajisje tjetër të dytë. Ndërmjet pajisjes së parë dhe asaj të dytë vendoset etiketa e mostrës, e cila duhet të jetë e dukshme dhe plotësohet nga trupa inspektuese;

- c) Në prani të subjektit, pajisjet (mbajtëset) mbyllen dhe plumbosen në mënyrë të tillë që hapja e tyre të çojë në dëmtimin e pandreqshëm të plumbosjes;
 - ç) Për të ruajtur anonimatin e mostrës, trupa inspektuese vendos një kod identifikimi në etiketë. Ky kod i përket subjektit të inspektimit dhe regjistrohet nga trupa inspektuese, duke u mbajtur i fshehtë deri në momentin e kthimit të përgjigjes së analizave zyrtare;
 - d) Prishja e plumbosjes së mostrave bëhet në momentin e dorëzimit në laborator, në prani të trupës inspektuese dhe përfaqësuesit të laboratorit marrës në dorëzim;
 - dh) Trupa inspektuese merr tre mostra, të cilat pasqyrohen në procesverbalin e marrjes së mostrës në sistemin elektronik “e-Inspektimi”, në lidhje me produktin për të cilin është marrë mostra.
4. Dorëzimi i mostrës, pranë institucionit që do të kryejë analiza të saj, bëhet si më poshtë:
- a) Dorëzimin nga trupa inspektuese të njërsë prej pesë mostrat dhe konkretisht mostrën kryesore (A) në laboratorin e akredituar apo të autorizuar, brenda afatit të përcaktuar nga inspektorati qendror përkatës, që nga momenti i marrjes së saj, në mënyrë që të shmanget çdo ndikim në ndryshimin e parametrave dhe vëtive fiziko-kimike të mostrës;
 - b) Katër mostrat e tjera (R1) dhe (R2) ruhen nga trupa inspektuese derisa të përfundojnë procedurat e verifikimit, ankimimit administrativ dhe gjyqësor të rezultateve/analizave të kërkua prej tij, duke i siguruar kushte për të ruajtur cilësitë e tyre fillostante;
 - c) Zhvillimin e procedurës specifike të marrjes dhe analizimit të mostrave sipas standardeve të përcaktuara nga çdo inspektorat qendror, me qëllim që të garantohet integriteti i parametrave dhe vëtive fiziko-kimike të të gjitha mostrave të marra.

KREU VII

DOKUMENTACIONI PËR MARRJEN E MOSTRAVE

Dokumentacioni për marrjen dhe dokumentimin e procedurës së marrjes dhe analizimin e mostrës, nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, përbëhet nga:

- a) Autorizimin e kryeinspektorit për kryerjen e inspektimit dhe marrjen e mostrave, në rastet kur kjo parashikohet në legjislacionin sektorial;
- b) Vërtetim për marrjen e mostrës që përbën emërtimin e mostrave respektivisht mostra (A), 2 mostra (R1) dhe 2 mostra (R2);
- c) Fotokopjen e faturës së blerjes që përshkruan sasinë e produktit të mostruar;
- ç) Certifikatën e origjinës dhe cilësisë për produktin e mostruar, të lëshuar nga shitësi;
- d) Raportin e përgjigjes së analizave për produktin e mostruar, të lëshuar nga laboratori;
- dh) Faturën për arkëtimin e pagesës së tarifës përkatëse.

KREU VIII

PROCEDURA PËR KRYERJEN E ANALIZËS LABORATORIKE

1. Kryerja e analizave realizohet sipas parametrave të miratuara nga inspektoratet qendrore përkatëse, për analizën e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve duke përshkruar metodat dhe pajisjet që përdoren. Analizat e kryera duhet të dokumentohen

dhe t'i bashkëngjiten procesverbalit të inspektimit, sipas fletë analizës të përcaktuar në shtojcën 3 të këtij vendimi.

2. Çdo inspektorat qendoror, duhet të jetë i pajisur ose të ketë në dispozicion logistikën e përshtatshme për marrjen, ruajtjen dhe transportimin e mostrave të marra nga subjekti i inspektimit.
3. Logistika dhe pajisjet duhet të jenë në përputhje me nevojat minimale dhe fushën e veprimit të inspektoratit qendoror.
4. Çdo inspektorat qendoror, në fushën e tij të veprimit, duhet të plotësojë kriteret minimale të përmendura në paragrin më lart, për logistikën e transportit të mostrave të marra nga subjekti i inspektimit.
5. Për qëllim të analizave cilësore të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve të subjektit të inspektuar, mostrat e marra nga trupa inspektuese dërgohen, për realizimin e analizave në një nga laboratorët e parashikuar në pikën 14, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, nëpërmjet vendimit të trupës inspektuese për kryerjen e ekspertimit të mostrës.
6. Çdo inspektorat qendoror duhet të ketë një listë të subjekteve shtetërore ose private, të akredituara, të miratuara dhe të autorizuara në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, të specializuara për kryerjen e analizave, për fushën ku inspektorati vepron.
7. Çdo inspektorat qendoror duhet, të paktën një herë në vit, të përditësojë listën sipas pikës 6 më sipër, paraprakisht në fillim të çdo viti kalendarik. Kjo listë duhet të jetë e publikuar në faqen zyrtare të inspektoratit qendoror dhe atë të sistemit "e-Inspektimit".
8. Lista e laboratorëve shtetërore ose private të akredituara, sipas pikës 6, duhet të miratohet nga ministri përgjegjës, pas marrjes së mendimit nga inspektori i Përgjithshëm.
9. Për çdo mostër të marrë, për sa i përket transportit dhe ruajtjes së tyre, duhet pasur parasysh, specifikat/karakteristikat e veçanta dhe individuale të çdo produkti, materiali, malli, substance, prodhimi, apo pajisje, procese e makineri.
10. Eksperti/ët, para kryerjes së ekspertimit duhet të nënshkruajë deklaratën e mungesës së konfliktit të interesave, si dhe të marrin përsipër kryerjen e ekspertimit në mënyrë objektive, të pavarur, profesionale dhe të paanshme, duke nënshkruar deklaratën e ekspertit. Në rast të mosbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga deklarata, eksperti mban përgjegjësi administrative deri penale.
11. Eksperti/ët pasi verifikojnë mostrën, objekt ekzaminimi, përpilojnë dhe nënshkruajnë aktin e ekspertimit, duke ju përgjigjur pyetjeve të këruara nga trupa inspektuese.
12. Analizat e realizuara duhet të regjistrohen në sistemin "e-Inspektimi" dhe dokumentet duhet të përfshijnë të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - a) Datat e analizave të kryera;
 - b) Emrin e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe kur është e aplikueshme, formën e dozën;
 - c) Inicialet e personave të cilët realizuan analizën;
 - c) Inicialet e personave të cilët verifikuan analizën dhe përllogaritet, kur nevojitet;
 - d) Një deklarim i qartë i lejimit/lirimit apo refuzimit (ose çdo statusi tjeter të vendimit) dhe datën e nënshkrimit të personit të caktuar përgjegjës;
 - dh) Numrin e seriës dhe kur nevojitet, fabrikuesin dhe/ose furnizuesin;
 - e) Referencat e specifikimeve përkatëse dhe procedurat e kryerjes së analizës;

- ë) Rezultatet e analizës, përfshirë vëzhgimet dhe përllogaritjet, dhe referencën për çdo certifikatë analize. Pas përfundimit të analizave, rezultatet e tyre regjistrohen elektronikisht në regjistrat e laboratorit nga personi **përgjegjës** i laboratorit të plotësimit të fletë analizës.
13. Fletë analiza me të dhënrat e rezultateve plotësohet në tre kopje, sipas kërkesave të trupës inspektuese, të përcaktuar në procesverbalin e inspektimit. Secila kopje firmoset nga analizuesi, përgjegjësi i laboratorit dhe titullari dhe ngarkohet në sistemin “*e-Inspektimi*” në çështjen përkatëse
14. Trupa inspektuese kryen vlerësimin **paraprak** apo përfundimtar të riskut për çdo veti/karakteristikë të produktit që lidhet me sigurinë e tij **sipas përcaktimit të legjislacionit** përkatës. Vlerësimi i riskut përfshin këta komponentë:
- a) rëndësinë/peshën e dëmit;
 - b) probabilitetin e prodhimit të dëmit.
15. Në bazë të rezultatit për çdo veti/karakteristikë, hartohet vlerësimi i përgjithshëm i riskut të produktit **sipas njërs prej këtyre kategorive:**
1. risk i ulët;
 2. risk i mesëm;
 3. risk i lartë;
 4. risk serioz.
16. Vlerësimi i riskut për çdo veti/karakteristikë dhe vlerësimi i përgjithshëm i riskut për produktin e analizuar kryhet bazuar në udhëzimin për vlerësimin e riskut të inspektoratit qendror përkatës dhe hidhet në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”, nga trupa inspektuese që ka kryer procedurën e inspektimit. Inspektorati i Përgjithshëm, krijon një bazë të dhënash për mostrat e mara nga çdo inspektorat qendror, si pjesë e sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”.

KREU IX

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE PËR ANALIZAT E MOSTRAVE

1. Inspektorati qendror përkatës përcakton **listën** e mostrave për analizë. Laboratorët e akredituar për kryerjen e analizave dorëzojnë paraprakisht një listë me tarifat për çdo analizë specifike.
2. Shpenzimet për analizën e mostrës përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a) Koston e logistikës për dërgimin dhe ruajtjen e mostrës.
 - b) Koston e testit/analizës laboratorike **sipas** metodës së standardizuar.
 - c) Shpenzimet administrative që lidhen **me** përpunimin e të dhënavë.
 - ç) Tarifat për përgatitjen dhe lëshimin e **raportit** zyrtar të analizës.
3. Kostoja totale e analizës për një mostër **llogaritet** si shumë e:
 - a) Tarifës bazë të analizës, sipas listës së miratuar nga laboratori.
 - b) Shtesave për analizë të përsëritur ose **analizë** të thelluar (nëse kërkohet).
 - c) Kostove shtesë për transport, ruajtje **ose** trajtim të veçantë të mostrës (nëse aplikohet).
4. Shpenzimet për analizën e mostrës, kur kërkohet nga subjekti i inspektimit në ankiminin administrativ, parapaguhen nga subjekti **ankimues**, nëse komisioni vendos për kryerjen e një ekspertimi të dytë.
5. Në rast se rezultatet e analizës së dytë janë të ndryshme nga rezultatet e analizës së parë, atëherë komisioni i shqyrtimit të ankimit mund të kërkojë kryerjen e një ekspertimi të tretë. Bazuar në

vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit, shpenzimet për analizat laboratorike do të paguhen nga subjekti ankimes në rast se ka kryer shkelje të kërkesave ligjore ose nga inspektorati qendror, nëse rezulton se subjekti nuk ka kryer shkelje të kërkesave ligjore.

6. Shpenzimet e marrjes së mostrës me kërkesë të subjektit të inspektimit, para hedhjes në treg të produktit parapaguhen nga subjekti i inspektimit, pavarësisht rezultatit të marrë në përfundim të procedurës.
7. Shuma e shpenzimeve përmarrjen dhe analizimin e mostrës pasqyrohet në vendimin përfundimtar të inspektimit.

KREU X
ANKIMI

1. Subjekti i inspektimit, mund të ankimojë vendimin me rezultatin e analizave të mostrave, brenda 5 ditëve, drejtuar Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, i cili fillon shqyrtimin e ankimit brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të ankimit. Së bashku me kërkesën ankimore, subjekti mund të kërkojë edhe përsëritjen e aktit të ekspertimit pranë këtij komisioni. Komisioni i ankimit në këtë rast duhet të japë vendim brenda afatit 30-ditor nga data e regjistrimit të ankimit. Në raste përashtimore, ky afat mund të zgjatet vetëm për shkak të kohëzgjatjes së kryerjes së analizave laboratorike.
2. Nëse ankimi nuk paraqitet brenda afateve të parashikuara në pikën 1, do të konsiderohet që, pala e interesuar (subjekti i inspektimit), është dakord me rezultatin e analizave të nxjerrë nga subjekti i akredituar, i përzgjedhur nga inspektorati, për mostrën e marrë dhe vendimin e marrë nga trupa inspektuese.
3. Inspektorati i Përgjithshëm i kthen përgjigje subjektit, i cili ka paraqitur ankimin brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankimit.
4. Në rast se subjekti i inspektuar, nuk është dakord me rezultatet e analizave të marra dhe vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit, ka të drejtë që brenda një afati 45-ditor të bëjë ankim në gjykatën kompetente.
5. Mos ushtrimi i kësaj të drejte brenda afateve të parashikuara, përbën shuarje të së drejtës për ankim në rrugë gjyqësore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama